



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Puniljeno/Protoloto Received/Delivery	06.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHQK	4610/2023		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.681/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.681/2023 të datës 27.04.2023, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 06.06.2023, mori këtë:

### V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.681/2023 e datës 27.04.2023, e parashtruar nga ankuesi

II. Çështja bie në kompetencë të gjykatës kompetente.

### A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 27.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref.253/2023 të datës 13.04.2023 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), për shkak të shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli me datën 12.05.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3865/2023 të datës 27.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Ref:253/2023 të datës

13.04.2023 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.Ref:431/2022 të datës 01.07.2022 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr.Ref:604/13 të datës 18.12.2013 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Njoftimin e datës 28.03.2019 nga Zyra e Sekretarit të MJD-së përmes e-mailit zyrtar lidhur me listën për gradime; Akt emërimit e ankuesit me numër 182 të datës 25.07.2016; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit me Nr-182/2016 të datës 18.10.2016 për ankuesin; Vendimin Nr:ZMP-93/2016 të datës 11.08.2016 nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së; Vendimin me numër ZSP-85/2016 të datës 21.07.2016 nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së; Vendimin me Nr.Ref:221/2016 të datës 25.05.2016 nga Ushtruesi i detyrës së Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr.145/2015 të datës 27.10.2015 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin me Nr.Ref:634/2018 të datës 13.07.2018 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Kërkesën për ngritje të gradës diplomatike të datës 20.12.2017 e parashtruar nga ankuesi për Komisionin për Grada dhe Disiplinë; Autorizimin e datës 18.04.2023 të përfaqësuesit ligjor të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.05.2023 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me Nr:130/2016 të datës 12.10.2016 nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së; Vendimin me Nr.047/2015 të datës 30.12.2015 për plotësim ndryshimin e vendimit Nr.145/2015 të datës 27.10.2015 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimin për shpallje të konkursit me Nr.140/2011 të datës 21.07.2011 të Ministrit të Punëve të Jashtme; Konkursin e datës 22.07.2011 si dhe listën e kandidatëve-aplikues për misione diplomatike-gusht të vitit 2011.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të shkresave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.681/2023 të datës 27.04.2023 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga analizimi i provave materiale Kolegji ka gjetur se Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Vendimin Nr.140/11 të datës 21.07.2011 ka miratuar shpalljen e Konkursit për përfaqësues diplomatik dhe konsullor në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashtme më datë 22.07.2011 ka shpall konkursin për drejtues dhe nëpunës të tjerë të misionit konsullor dhe për anëtarë të misionit diplomatik, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi i renditur në listën e kandidateve-aplikues për misione diplomatike të muajit gusht 2011 me numër rendor 38.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se lidhur me këtë procedurë konkurrimi ishte organizuar vetëm testimi i gjuhëve të huaja dhe intervista me gojë, dhe nga kjo fazë nuk ka dëshmi për vazhdimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit në fjalë, gjegjësisht pranimit të ankuesit në pajtim me dispozitat e aplikueshme për shërbimin e jashtëm dhe shërbim civil.

Rrjedhimisht, nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se bazuar në Vendimin Nr.Ref:604/2013 të datës 18.12.2013 të Ministrit të Punëve të Jashtme ankuesi është emëruar anëtar i shërbimit të jashtëm duke i'u caktuar grada diplomatike *Këshilltar* dhe me këtë rast është caktuar të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Holandës nga data 01.01.2014, i njëjti ka vazhduar të ushtroj këtë funksion diplomatik deri me datë 13.04.2023. ku sipas Vendimit Nr.ref: 253/2023 të datës 14.04.2023 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është shfuqizuar Vendimi me numër reference 604/13 të datës 18.12.2013



lidhur me emërimin e ankuesit në shërbim të jashtëm si dhe Vendimi me Nr.Ref.431/2022 të datës 01.07.2022 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se vendimi i kundërshtuar më ankesë karakterizohet me shkeljeve të dispozitave ligjore, shkelje formale-procedurale, dhe shkeljeve të ligjit material, konkretisht Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm në kohën e emërimit të ankuesit në shërbim të jashtëm, përkatësisht nenit 3 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *4. Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomantik me të cilin parashihet: Anëtarët e Shërbimit Diplomantik të Kosovës, përveç të emëruarve politik, janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe personeli i tij i nënshtrohet të njëjtave paga, kërkesa dhe kushte të punës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose me ligje tjera ose akte nënligjor, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se përveç të emëruarave politikë, nëpunësit e shërbimit të jashtëm përfshirë personelin diplomatik, konsullor dhe personelin administrativ të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme apo të angazhuar në shërbim të jashtëm, kanë statusin e nëpunësit civilë dhe së pranimi i tyre në shërbim të jashtëm duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbim të jashtëm dhe legjislacionit të aplikueshëm për shërbim civil, andaj, mbi këtë bazë ligjore, si dhe duke marrë parasysh faktin se ankuesi ishte emëruar në shërbim të jashtëm mbi bazën e vendimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, e meqenëse me asnjë provë nuk vërtetohet se i njëjti ka themeluar marrëdhënie të punës në shërbim civil përmes nënshkrimit të Aktit të emërimit ashtu siç përcaktohej me nenin 19 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin parashihej se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkresë të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil....*, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.681/2023**

Ardita Perçuku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës së Jashtme dhe të Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punës së Jashtme dhe të Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së